



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

VENDIM

Nr.12 datë 17.04.2019

**PËR
“MIRATIMIN E RAPORTIT TË VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP) PËR VITIN 2018 ”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Ilir Zela	Kryetar
Znj.	Ketrin Topçiu	Anëtare
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtare
Znj.	Xhoana Lilaj	Anëtare

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 17.04.2019, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr.7 datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2018 ”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 9, pika 1 e nenit 114, dhe pika 1 e nenit 115, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918/2008**);
2. Neni 8 i ligjit 46/2015 “Për shërbimet Postare ne RSH (**ligji nr. 46/2015**);
3. Vendim i Kuvendit të RSH nr.134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik” (**Vendimi i Kuvendit nr.134/2018**);
4. Rregullore e Brendshme “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar (**Rregullore nr.7**);

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Projekt-raporti i Veprimtarisë së AKEP për vitin 2018;
2. Relacioni shpjegues mbi projekt-vendimin (**Relacioni**);
3. Projektvendimi i Këshillit Drejtues për miratimin e “Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2018”.

V Ë R E N:

1. Projekt-raporti i paraqitur pasqyron në mënyrë të plotë dhe korrekte veprimtarinë e AKEP për vitin 2018 dhe është hartuar bazuar në raportimet e bëra nga secila drejtori e AKEP mbi veprimtarinë e kryer, gjithashtu përmban edhe çështjet e detyrueshme për raportim të përcaktuara nga Kuvendi lidhur me institucionet në monitorim;
2. Përmbajtja e Projekt-raportit përmbush kërkesat ligjore të përcaktuara në:
 - i. Nenin 9, të ligjit nr.9918/2008
 - ii. Nenit 8, të ligjit nr.46/2015
 - iii. Vendimin e Kuvendit nr.134/2018
 - iv. Rregulloren e Brendshme të AKEP

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Pasi e gjen projekt-raportin në përputhje me kërkesat ligjore, në mbështetje të pikës 1 të nenit 114 , të pikës 1 të nenit 115, të ligjit nr.9918/2008 si dhe Rregullores së Brendshme,

V E N D O S I:

1. Të miratojë “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2018”, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Të dërgojë “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2018”, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, dhe një kopje e tij, t’i dërgohet edhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
3. Ky vendim publikohet në faqen e internetit të AKEP, së bashku me “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2018” ;
4. Ngarkohet Kabineti për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar
Ilir ZELA

Anëtar
Edlira DVORANI

Anëtar
Ketrin TOPÇIU

Anëtar
Xhoana LILAJ